ADEM ZAPLLUZHA

KRAKËLLIMAT E NATËS

Redaktor :
Sokol Demaku – Koli

Recensent :
Mazllum Baraliu

Lektor:
Sokol Demaku- Koli

ADEM ZAPLLUZHA

KRAKËLLIMAT E NATËS

Shoqata e Shkrimtarëve
“Fahri Fazliu”
Kastriot, 2014

NJË JETË E TËRË DHENË PAS POEZISË DHE ME POEZINË

Një jetë e tërë dhënë pas poezisë dhe me poezinë, e ky është poeti dhe shkrimtari Adem Zaplluzha, i cili na vjen pas prozës poetike "Fjetëm njëqind shekuj" me buqetën e tij poetike më të freskët "Krakëllimat e natës", e cila buqetë poetike shpalos me mall dhe ndjenja shpirtin e poetit nëpër kohë dhe vuajtje e mundime shpirtërore.

Përmbledhja poetike "Krakëllimat e natës", është ndarë në tre cikle, të cilët secili në vete ngërthejnë dhe mbajnë gjallë vrullin e poetit për një të ardhme më të mirë. Ciklin e parë autori e ka titulluar "Ishte koha e një kohe", cikli i dytë "Krakëllimat e natës" dhe i treti " Një zog i trishtuar".

Autori bënë një shëtitje nëpër kohë, bënë një lëvizje, e cila lexuesit i jep mundësin që të njihet dhe përjetoj kohën dhe përjetimet e kohës, duke u nisur nga koha antike, duke përdorur filozofinë tij prej poeti, filozofinë e fjalës, në paraqitjen e realitetit të kohës dhe jetës.

E një fjalë e urtë filozofike shqiptare na thotë: "*Njeriu nuk është i përjetshëm, le të përpiqet të jetë e pavdekshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të*

*bëjë",*e këtë lexuesi do e gjejë në punën dhe veprën e autorit të buqetës poetike "Krakëllimat e natës.

Poeti Adem Zaplluzha në shpirt ka një gurrë të pashtershme frymëzimi të veshur në stilin dhe modelin e lirikës sonë popullore. Në vargjet e tij do hasim kohët e shkuara me të gjitha të ligat të cilat më shekuj renduan mbi supet tona dhe se lan rrënjët, të cilat edhe sot e kësaj dite na dalin dhe na *"zgërdheshen si macet e zgjebosura"*dhe se në mënyrë alegorike poeti ve në pah të bëmat të cilat kanë edhe sot e kësaj dite rrënjët nga lashtësia sepse autori thotë: *Dallgët e liqenit/Nuk fjetën atë natë/S'i zuri gjumi as zogjtë e ujit/Te shkallët e një gjëme/Po përgatitej preja e një mali/Që nuk shembej me asgjë.*

Por është shumë magjepse ndjenja e poetit për kohën e kaluar, për fëmijërinë e tij që ai atë e gërsheton më ëndrrat të cilat e kthejnë në kohën e ninullave të tija, pro të cilat ninulla kanë humbur diku e autori thotë: *Kur më ngatërrohen ninullat/Dhe më humbin rrugët e gjumit/Te unë zgjohet fëmijëria.*

Por kjo fëmijëri është e zymtë ka humbur rrugën sikur anija që do të fundoset e nuk gjen do të shpëtim: *Dielli në horizontin e përskuqur/Noton si anijet e fundosura/Mbi shpirtrat e pafajshme të mjegullave.*

Nga këtu e fillon poeti ciklin e dytë të buqetës në fjalë, i cili cikël ve në pah ndjenjën e fëmijërisë se autorit por edhe filozofinë dashurisë së kohës, e këtë përmes poezisë "Krakëllimat e erës" nga e cila poezi edhe vëllim i mori titullin.

Të kujtohet/Valsi jonë i parë/Ne ishim pak kokëfortë/E pak më shumë konfuzë/Stinës i vinte një erë borziloku/Kurse flokët e tua kaçurrela /I përngjanin aromës së tërfilit/I cili depërtonte nëpër shqisa/

Pa trokitur /Në asnjë portë të mendjes.

Dhe se koha bashkëkohore ka pasur ndikimet e saja në rrjedhat e jetës dhe se ndikimi i saj ndihet në të gjitha poret e jetës:

Kur u rritëm/Nuk i përngjanim më vetvetes/Nga rropullitë tona /Filluan të fryjnë disa lloje erërash/Krejtësisht ishte më ndryshe/Kur ishim të vegjël/Jetonim pa i njohur dredhitë e njerëzve/

U besonin pafajësisë së fluturave/Tërë ditën loznim /Me të gjitha speciet e zogjve.

Autorin e brenë në shpirt dhe ai këtë e ndjenë me keqardhje se tani ne nuk jemi ata të cilët duhet të jemi, kemi humbur atë që na lanë trashëgim të parët dhe se kjo:

Asnjëherë në jetë/Nuk kuptuam se kush jemi ne/Të gjallët e rrjepin /Kurse të vdekurve me një elegancë/Ta paparë/Ua veshim pantallonat/Këpucët dhe këmishët e reja/Nuk e harrojmë as kravatën.

Vuajtja shekullore që ka rendua mbi supet tona ka lënë vragë të thellë në ndjenjat e poetit dhe ato vragë janë prezent edhe sot ndër gjenerata:NJERËZIT MË NUK DINË

Mos të lutem/Mos i hap portet e dhembjes /Të kësaj nate të gjymtë/Hijet kaherë /I vranë merimangat e zeza/Një kambanë që disa shekuj/Po vajton golgotën e fateve të fluturave/Kryqet u dehidruan në shi/Vetëm një zë si mallkim i lashtë/Dëgjohet nëpër eterin e pluhurosur.

Por autori është optimist dhe se ndjen se rruga e trasuar do jetë ajo e cila do ndritë dhe të gjithë së bashku do ecim përpara:HARABELAT

Çdo njeri e ka historinë e vet/Një palë këpucë vrapojnë rrugëve/Vrapojnë /Deri sa të shqyhen shollat/Si një hartë e grisur prej letre/Po duket atdheu im.

Në ciklin e tretë," Një zog i trishtuar", defilojnë tituj poezish idilike, poezi të cilat japin jetë dhe shpresë për një të ardhme më të lumtur si: *NËSE NGJAN E KUNDËRTA/ULEMI TE PRAGU I DERËS/NGA*

LËVORJA E DRURIT/NJË ZOG I TRISHTUAR/JONI NOSTALGJIK/NJË ZOT I HARRUAR/NGA SYTË E TUA/FRYJ SA TË DUASH/KUR MË ZURI PLEQËRIA/ dhe shumë poezi tjera të cilat janë një realitet i jetës në të cilën poeti jeton.

Më ka rënë të dëgjoj, por edhe në jetë e kam provuar edhe vetë se botimet e librave janë tubime të këndshme ose festa të përbashkëta të atyre që krijojnë dhe atyre që adhurojnë gjuhën dhe letërsinë, si lexues të çdo moshe dhe gjinie. Se libri është ai që bashkon njerëzit, se libri është pishtar i madh i cili rrezaton dritë e dituri te njerëzit.

Sokol Demaku

Ishte koha e një kohe
Cikli i parë

ISHTE KOHA E NJË PASHAI

Mes rreshtave të një poeme
Teatri i njohur antikë
I ka shtrirë krahët
Dhe zgërdheshet
Si macet e zgjebosura

Këtu nata këlthit
Jo nga vaji
Por nga krakëllima e një korbi
shpirt sterrë

Mbi ballin e rrudhosur të liqenit
Si pulëbardhat e egra
Fluturuan do zogj nate
Dhe kurrë më nuk u kthyen
T'i njomin sqepat
E kafshuara të fjalëve

2.

Pa përfunduar akti i parë
Në gjymtyrët e skenës së baladave
Filluan krakëllimat
Tani më të njohura
Të erës

Thanë se është fundi i mjegullave
Por njerëzit s'ndaleshin të mendojnë
Piskamat lindnin trishtime
Britmat piskama
Edhe më të tërbuara

Dallgët e liqenit
Nuk fjetën atë natë
S'i zuri gjumi as zogjtë e ujit
Te shkallët e një gjëme
Po përgatitej preja e një mali
Që nuk shembej me asgjë

Në basamakun e tretë
Në këmbë qëndronte
Një shkëmb prej mishi
I cili asnjëherë
Dhe askurrë nuk u gjunjëzua

3.

Nga murishtat e kalasë
Një siluetë
Mbase paska filluar
Me çelë si lulja e kripës
Një tragjedi të re

Në ballkonin e sipërm
Një fllad dilte
Nga xhepat e çallmave
Dhe frynte me një trishtim të paparë

Gishti tregues i mbretit antik
Drejtohet kah toka
Një jetë njeriu
Tani më rrëshqet në harresë

4.

Britmat me gjasa ende dëgjohen
Nëpër kthinat e kujtesës
Një luan i tërbuar nga era e gjakut
Shikon habitshëm
Se si ulërinë njerëzit
Jashtë mureve veç ka filluar
Të bie një shi imcak

Qanin edhe gjethet
Nuk pushonte as xhadeja
Diku pas maleve
Hungëronin deri në tërbim
Një derr i egër
Dhe një varr i hapur

5.

Pelerina e bardhë
Mbase ajo bardhësi dallohej
Shumë pak
Nga ngjyra e qershisë
Një hije e kuqërremtë
Fshihej si fantazma pas mureve

Në anën e kundërt të sarkofagut
Dallohej një kryq prej gjaku e mishi
Ngulur në shpirtin e tokës
Ose në kokën e një njeriu
Po kalben arkivolet

Një kryq
I gozhduar në zemrën e mjegullave
Qante si kërthi te korijet
Fatin e një tragjedie
Që asnjëherë nuk e luajtën
Aktorët e një kohe të leckosur

6.

Qeshnin edhe zambakët
Me fustanin e erës
Joni i lustronte këpucët për festë
Nga gjëma e shekullit
Dolën ca zëra
Që i përngjanin atyre të cirqeve
Teuta si kurrë më parë
E mprehte shpatën e dallgëve
Dhe aq bukur i dukej
Fustani i kaltër prej algave
Sa që ja merrte bukurin detit

7.

Peshqit nuk pushuan gjatë tërë natës
Edhe një tjetër valle lozej
Ajo e mortit
Në maja shpatash

Gurgullonte qeshja e Ali Pashait
E Janina
Askujt nuk i tregoi ëndrrën
E një bese të thyer
Ëndrrën
E një kali të egër
I cili vraponte drejtë skëterrës
Me dizgjin prej shevari

8.

Thonë se atë natë
Liqeni nuk vuri gjumë në sy
Tërë kohën gjëmoi
Për një trishtim që e prite

Dhe erdhi mëngjesi
Dy palë sy
Si dy liqene qanin
Fatin e një rrapi të prerë
Nuk dihej më
Se nga cila anë frynte liqenza
E pjelljes së tradhtisë

9.

Shumë ngadalë
Me hapa të plumbta
Kërcëllinin rrotat
E një araba mbushur me zhivë

Hijerëndë
Dhe me plotë madhështi
Dëgjohej uturima e peshkves
Mbi pluhurin e një xhadeje
Kalonte vdekja

Një gjysmë trupi
Si shpirti i sfinksit
Mbeti në Janinë
Kurse koka
Ah sa koka shqiptarësh
Thaheshin si këmishët e luftës
Në kamaren e turpit

10.

Kam dëgjuar
Ashtu thonë se e vetmja kokë
Që nuk qëndroi as një natë
Të plotë
Në atë kamare kokësh
Ishte ajo e shpirtit të Tepelenës

Ishte koka e një pashai
Që deshi të vdesë
Dhe të varroset
Vetëm në vegimin e përgjumur
Të Këlcyrës

11.

Po të lindja edhe njëmijë herë
Nuk do të doja asnjë fat tjetër
Përpos të Ali pashait

Kokat përherë udhëtojnë dika
Por trupi
Mbetet si një mal
Që s'lëviz nga vendi

Le të jetë koka në Stamboll
Ose ku ta di unë se ku
Ama trupi
Dhe këpucët
Le të më varrosen në atdhe

Ky teatër antik
Nuk di a ishte dikur përrallë
Ose vetëm sot zgërdheshet
Me aktorët e panjohur

Kur dal nga poema
Ose hy në ëndrrën e saj
Dua që trupi dhe koka ime
Sërish
Dhe sërish të varrosen në atdhe

12.

Në flokët e shprishura
Të dallgëve
Hingëllonte një kalë i kuq

Liqenza frynte
Nga të gjitha anët e ndërgjegjes
Në teatrin e bejlegut
Një mjekër bardhë luante
Me tespihe prej kristali

Era frynte e frynte
Mbi lisat e sëmurë
Flinte ëndrra e një zgjebe

Atdheu lëngonte si kurrë më parë
Nga një sëmundje aziatike
Një kalorës i zi
I përngjante sterrës së verbët
Kudo sterrë në hapësirë
Dhe shpirtra

Në sytë e përlotura të nënave
Krakëllimat e çafkave
Mbulonin qiellin
Që lëngonte me shekuj

13

Mbase pritëm kot
Ta lozim rolin në aktin e parë
Pa i njohur mirë si duhet rregullat
E një drejtshkrimi të çoroditur
E mashtruam atdheun

Ishin si duket disa ëndrra
Të shthurura
Nuk dihej kur është mëngjesi
Dhe ku të zinte mbrëmja

Sekrete fantazmash të vdekura
Fshiheshin nën arkivolet prej eshtrave
Ishte një natë e tmerrshme
Natë e thikave të gjata

Kur e rrjepën hënën
Sterra fshihej pas hithrave
Vetëm gjaku belbëzonte
Në një gjuhë krejtësisht të panjohur

Nga një minare e re
Ende dëgjohej gjëma e një kryqi
Dhe vaji i tërthortë
Në lotin e një gruaje të dhunuar

Njerëzit me gjasa luteshin kot
Zoti i tyre i verbër
Veç kishte filluar t'i harroj
Orakujt e dehur
Nga kënaqësitë e çasteve banale

Ose nuk kishin ekzistuar
Asnjëherë më parë
Hijet e atyre perëndive
Në këto fusha të shkelura
Prej patkonjve të ndryshkur

Kujt t'i luteshin në këto çaste
Fëmijët e erës së algave
Mbase kishin vdekur
Edhe zotat pagan

Asnjë faltore nuk bëzante
Një heshtje e trishtuar
Përzihej tinëzisht
Me gjakun e shprishur të frikës

14.

Zoti im
Nëse mund të të quaj kështu
Ku ishe dje
Dhe në cilën ëndërr ike sot
Ku po fshihesh
Të ishe Zot si duhet
U kishe dalë zot zogjve pa fole

O Zot i im
Si të mbështetem në forcën tënde
Kur as vetveten
Nuk je në gjendje ta mbrosh

Zoti im
Mal i çmendur pa rrënjë
Ku është arkivoli yt
Me lejo të flijohem për frikën tënde
Me lejo ta zhgozhdoj sfinën e dhembjes
Nga shtati i lisit

Zoti im
Mos je shurdhuar
Apo nuk je duke dëgjuar aspak
Gjëmën e njeriut të vogël

15.

Mali me lisa po digjet
O Zot i im
Këputi dizgjinët e frikës
Dhe eja të zgjohemi nga kjo zhgjëndërr

Një djep diku te rapsodit
Po qanë me shekuj
Nën mështeknën e djegur
Fshihen faqet e një libri të vjetër

Mali me lisa e rrënjë
Po digjet
Të kujt janë këto duar
Që po i përkundin gjethet

I kujt jeni Ju o Zot i im
Ku ishit dje
Dhe ku jeni sot
Që na lë kështu jetim

Të përgjërojnë drurët
Mollët nëpër kopshte s'kanë më gjethe
O Zoti im i madh
Të padurueshme qenkan këto ethe

16.

Një mik më pat thënë
Se jam një lis pagan
Tjetri nga mëngët i shkund
Të gjitha zotat e mi

Kurse unë
As nënë nuk kam
Të më vajtoj për së gjalli

Më kanë ikur zogjtë nga mendja
Asnjë fjalë e urtë
Nuk gjendet në fjalorin tim
Vetëm kolonadat e disa perëndive
U bëjnë hije përgjumjes së lisave

E lisat prehen si arkivolet
Te varret e bardha
Zoti im
Te ato varre
Ku janë varrosur nga dy veta

Kush po i fsheh hingëllimat e luftës
Këto daulle që s'pushojnë
Mbase lindën nga librat e vjetër
Ashtu siç lindi tradhtia

17.

Te çezma
Dëgjoheshin disa çjerrje zërash
Nuk di
Athua i përngjante njeriut
Ose njeriu
I përngjante lehjes
Në majat e thikave të ndryshkura
Nata ishte e gjatë

Prishtinë, 22. Qershor 2013

18

Mbi një dunë të vjetër
Qante dervishi i ri
Shandanët me qirinj prej eshtrave
Paskan mbetur
Pa drita fosforeshente

Nata disi i kishte humbur
Orientimet e ecjeve
Kalëronte mbi një deve të lodhur
Me katër gunga

Gjethet e fishkura
Për herë të parë derdhën lot
Nëpër xhadenë e kalldrëmtë
Iknin kalorësit dështak

Një vaj i llahtarshëm
Dëgjohej edhe tejpërtejmes
Yjet në grevë urie
Sa pak ndriçojnë sonte xixëllonjat
Udhën e qumështit në ikje

19.

Te fanari ishin kyçur dritat
Asnjë anije nuk u kthye mbrëmë
Vetëm varkëtarët llamburitnin
Mbi llahtarinë e një tragjedie

Te basamakët
Asnjëherë më nuk çelën zymbylat
As zambakët e Dukagjinit
Nuk ndjehen më mirë

Nënat me shamia të zeza
U përngjajnë qyqeve
E qyqet nënave

Qajnë edhe lisat e djegur
Qajnë gurët e një atdheu të kafshuar
Një arabaxhi i moshuar
Mbase ky njeri nuk qanë
Asnjë pikë loti që i përngjan peshkves
Nuk paska mbetur
Në sytë e sfilitur të erës

20.

Nuk di se ku e mësuan njerëzit
Për fillimin
Nuk ishte në fillim
Një fillim i ri
Por përfundimi i një poeme
E cila lindi në malet e Këlcyrës

Ishte një histori e rastit
Shpirti rebel donte hakmarrje
Kurse një lumë
Nuk i përngjante më asnjë lumi

Derdhej duke gjarpëruar ledheve
Si gjarpri i sëmurë
Një hije e zezë
Me do krakëllime korbash
Mbase nuk donte të ndalej kaq afër
Synonte varrin e të gozhduarit

Me një vajë të padëgjuar
Qanin malet e stralltë të hënës
Meteorët këputeshin nga hapësira
Si kokrra molle pa gjethe
Netët aziatike
Nuk i ndalnin avazet e vjetra

Qante edhe një nënë pa burrë
Kush do ja mbylli arkivolin
E syrit të hapur

Këlcyra zgjohej si e çmendur
Nga një ankth i llahtarshëm
Netët më nuk kishin gjumë

Në ofshamën e lumit idhnak
Në dysh u ndanë
Tespihet
Prej një mallkimi të stralltë

21.

Më duket se ndonjëherë
Nuk kam lidhje me historinë
Sa herë që desha
T'i zgjoj baladat
Para syve të gështenjtë të frikës
Çmalleshin me të kaluarën
Rapsodit e të gjitha kohërave

Nuk lash libër pa lexuar
Mbase një histori e ngjashme
Po përsëritet edhe kësaj here
Një kërthi i dehidruar
Ka gjasa
Të mbijetoj përmbytjen e mjegullave

22.

Një hije fut e zezë
Mbante në dorën e djathtë
Një legen bakri
Era pëshpëriti si në ethe
Është koha e avdesit

Sfinksi i maleve
Shikonte me përbuzje
Dorën që dridhej mbi kokën e malit
Dridheshin
Edhe flluskat e lotit të pikëllimit

Lartë në qiell
Disa yje endacak
Shikonin si në teatrin antik
Mjekrën e bardhë të Këlcyrës

Liqenza edhe kësaj herë
Nuk e njohu frikën
Shikonte lotin e legenit
Se si përtypej nga tmerri

Te plepat e liqenit befasisht
Pushuan krakëllimat
Asnjë zë çafke
Nuk i pëshpëriti fjalët e ringjalljes

23.

Si nga një lashtësi e tejdukshme
Luani u ngrit në dy këmbët e pasme
U ngritën edhe lisat
Rrapi plak
Përmallshëm lotoi si era

Në ahurin
Përballë shelgjeve të pikëlluara
Hingëllonte vetëm gjoku i Lekës
Hingëlloi edhe nata e fundit
E syve të kaltër

Një hënë humbi te mjegullat
Këlcyra kësaj herë
Dënesi për herë të fundit
Me lotët stralltë të egërsisë

Prishtinë, 23 qershor 2013

Cikli i dytë
Krakëllimat e natës

NJË ZOG SHTEGTAR

Kur më ngatërrohen ninullat
Dhe më humbin rrugët e gjumit
Te unë zgjohet fëmijëria

Dal nga lëkura ime
Dhe te petalet e zambakëve
I lexoj të gjitha epitafet e varreve

Dielli në horizontin e përskuqur
Noton si anijet e fundosura
Mbi shpirtrat e pafajshme të mjegullave

Diku në rrugën e qumështit
Si krimbi i mëndafshit
Çelin rapsoditë

Një lahutë nëpër hane
Pushon mes trarëve të tymosura
Dhe dënes si një kërthi i harruar

Mjegullat bisedojnë
Për çastet e kohërave të kaluara
Të cilat për çdo ditë
Ndryshojnë formën e ekzistencës

Larg nën hijen e mështeknës
Te përroi
Nuk ndalet kurrsesi gurgullima
E shirave të vjeshtës

Një zog shtegtar
Mbase i paska harruar
Të gjitha ngjyrat e fluturimeve
Me orë të tëra bisedon në heshtje
Me një arkivol të kaltër prej letre

KRAKËLLIMAT E ERËS

Të kujtohet
Valsi jonë i parë
Ne ishim pak kokëfortë
E pak më shumë konfuzë

Stinës i vinte një erë borziloku
Kurse flokët e tua kaçurrela
I përngjanin aromës së tërfilit
I cili depërtonte nëpër shqisa
Pa trokitur
Në asnjë portë të mendjes

Çdo gjë na dukej atë natë
Si një roman
Që e shfleton kot
Dhe nuk mund ta lexosh
Pikat dhe pikëpresjet
Që në fillim na mbetën në grykë

Një serenatë nate
Na dukej si muzika e gjetheve
Dy zogj
Mbi telat elektrike
I shkëmbenin mendimet
Një galop i paparë
U paraqit në fushën e mjegullave

E shiu nuk dinte të ndalej
Nëpër çatitë e djegura të Prishtinës
Në një këmbë
Ende qëndronin çafkat
Krakëllimat e erës së djegur
Nuk kishin të ndalur

Prishtinë, 24 qershor 2013

KY FIS

Kishte mbërri te ne përtej maleve
E deteve të çmendur
I gozhdonte fluturat nëpër lisa të kalbur
Ky fis nuk paska as fe
Por nuk është as pagan

Fëmijët e vetë i varrosin
Nëpër sinor
Kur janë të etur
Dhe të uritur
Si lukuni qensh kafshojnë njëri-tjetrin

Ky fis
Që nuk i përngjan njeriut
Ende është në hulumtim të vetvetes
Lind dhe vdes
Ngjashëm me vdekjen e meteorëve

KURSE GJATË TËRË DITËS

Kur u rritëm
Nuk i përngjanim më vetvetes
Nga rropullitë tona
Filluan të fryjnë disa lloje erërash
Krejtësisht ishte më ndryshe
Kur ishim të vegjël

Jetonim pa i njohur dredhitë e njerëzve
U besonin pafajësisë së fluturave
Tërë ditën loznim
Me të gjitha speciet e zogjve

Bretkosave ua mbaronim shtëpitë
Në disa kutia kartoni
Dhe thjeshtë
Donim çdo gjë
Që mund të prekej me dorë

Ishim të lumtur
Qielli mbi kokën tonë nuk kishte sinor
U përngjanim zogjve
Cicëronim në shumë gjuhë
Këngët e njëri - tjetrit

Por sot kur u rritëm
Filluam të mendojmë ndryshe
Netëve të vona hapim varre
Kurse gjatë tërë ditës
Vajtojmë si gratë e liga

ENDE NUK JAM I SIGURT

Ajo i kishte duart delikate
Përplot gjallëri
Sa herë që i lidhte nyje
Flokët e mia
Dita qeshte si një fëmijë

I mbushte grushtet
Me vesën e hershme të mëngjesit
Dhe tërë ditën e lume
Ua shuante zogjve etjen
Nuk i përngjante askujt
Përpos një nëne

Ende nuk jam i sigurt
Se çfarë ishte ajo
Ishte engjëllushe
Nënë e mirë ose një vashë
Lindur nga baladat
Por duart e saja
Shëronin çdo plagë të rinisë

POR KËTË QË BËJMË NE

Asnjëherë në jetë
Nuk kuptuam se kush jemi ne
Të gjallët e rrjepin
Kurse të vdekurve me një elegancë
Ta paparë
Ua veshim pantallonat
Këpucët dhe këmishët e reja
Nuk e harrojmë as kravatën

Në disa rasate të rralla
I përcjellim me muzikë mortore
Arkivolet i ngjyrosim me disa lloje ngjyrash
Që të duken më alegro
Ose sipas dëshirës së familjarëve
Deri në dehje
Pimë për shëndetin e askujt

Rrugës në kthim gjuajmë me fjalë
Njëri - tjetrin si me gjuhë gjarpri
Dhe me padurim presim
Një dehje tjetër më madhështore

Nuk di më
Me çfarë të krahasohemi
Por këtë që bëjmë në vetëdijen tonë
Nuk i përket asnjë njeriu

SI TRENAT E VERDHË

Një hënë e re
Del dhe zhytet në kujtesën time
Po ashtu edhe një ëndërr e një vjeshte
Fundoset te korijet e pasosura
Mbase dimri sivjet
Në prehrin e gjetheve
Nuk duket edhe aq i lumtur

Lisi i vetmuar te dunat
Përmallshëm këndon
Një baladë për lejlekun e bardhë
Sivjet asnjë zog shtegtarë
Nuk u ndal te mullarët e lagjes
Ta ndërtoj çerdhen

Ne nuk kishim kohë
Ose nuk ditëm t'i perceptojmë
Ardhjet e shirave
Dimrat këtu janë të pashpirt
Lotët e zogjve
I shndërrojnë në kristale të akullta

Me gjasë stinët sivjet
I kanë humbur itineraret
Si trenat e verdhë
Kalojnë vërdallë këndej fluturat
Edhe në këtë pritje të pashpresë
Të kthimit të zogjve
Ora diellore
Po i përjeton sërish
Mungesat e shirave të bardha

NJERËZIT MË NUK DINË

Mos të lutem
Mos i hap portet e dhembjes
Të kësaj nate të gjymtë
Hijet kaherë
I vranë merimangat e zeza

Një kambanë që disa shekuj
Po vajton golgotën e fateve të fluturave
Kryqet u dehidruan në shi
Vetëm një zë si mallkim i lashtë
Dëgjohet nëpër eterin e pluhurosur

Im atë ndjesëpasti
Në çdo kohë tregonte përrallën
E një molle të kafshuar
Tregonte
Se sa lehtë mund të mashtrohet njeriu

Era frynë e frynë nga të katër anët
E hemisferës
Njerëzit më nuk dinë
Se kah i bie Jugu e kah perëndimi
Një breshkë deti
Si një varkë e humbur
Noton në lotin e tokës

NJË MJAULLIMË E ZEZË

Si nga baladat dalin njerëzit
Nga shpirtrat e drurëve
Një pranverë ikën tej gjetheve
Vjen tjetra si uturimë e vjeshtës

Kam përjetuar edhe ditë më të liga
Por nuk durohet
Ky lot dreri
Një mjaullimë e zezë
Si të ishte e huazuar prej djajve
Vinte nga ana perëndimore e kalasë

Lumëbardhi si kurdoherë vigjilent
Bisedonte me gjethet
E këputura të një vjeshte
Kurse dimri qëndronte te malet
Si këmbëza e ngrehur e pushkës

Ne kur nuk kishim se çfarë të bëjmë
I ndryshonim itineraret e trenave
Ora e vjetër në stacion
Tani më asgjë
Askujt nuk i tregon
Heshtja e saj i përngjan sfinksit
Në fund të lagjes së evgjitëve
Lehjet posa kanë filluar të ekzaltohen

Mbrëmë hëna e dërmuar hingëlloi
Një kohë të gjatë
Erdhën një grumbull hajdutësh
Dhe nuk lënë asnjë fije bari mbi tokë
Një lis i moçëm
Shfletonte përrallën e harruar
Te një stinë e venitur

MALLKIMI I PASQYRËS

Për çdo ditë
Nga mendja shpërthejnë kuajt e zjarrtë
Ajri i përskuqur belbëzon
Në prapavijë
Një psalm e lashtë buron nga toka

Hijet e tymosura si stiva drurësh
Të prerë thahet në shtrojerë
Nën trarët e djegur të hanit
Sa e gjatë qenka sonte
Kjo rruga e rapsodive

Një det i paanë
Shtrihet në pasqyrën e mëkateve
Honet si zogjtë e pashpresës
Çelin një lloj trishtimi

Troku i çmendur i erës
S'mund të ndalet asnjëherë
Në asnjë shteg të vetmisë
Nuk zbresin engjëjt

Ka më se njëqind vjet
Që po ngjan ky udhëtim
Nëpër mendjen e brishtë të mjegullave
Dëgjohen vetëm zëra të vetmuara

Njëqind mallkime
Lindin në pasqyrën e imagjinuar
Të shiut të trentë
Në murin përballë heshtjes
Te një mëkat
kanë filluar të çelin zambakët

Era tinëzake
Frynte nga të gjitha pjesët e trurit
Frynte
Dhe nuk dinte të ndalej
Mallkimi në syprinën e etjes

DIKU NGA MALET

Kam dëgjuar prej të tjerëve
Se bjeshkët jetojnë me qindra vite
Në shpirtrat e drurëve
Mbështjellë
Me një magji prej gjetheve rriten shpresat

Sa herë që vrapon këndej pari
Nusja e lalës
Milingonat e kuqe
Fshihen nën rrënjët e rrapit

Dimrat nuk vijnë këtu
Për t'i larë mëkatet
Por sa herë që kalojnë këndej pari
Mëkatojnë
Si pasqyrat në murrët e përrallave

Diku nga malet
Për çdo ditë
Zbret një mjegull i hirtë
Fushat mbulohen me trishtimin e pritjes

Një korb i zi nate
Asnjëherë nuk i ndali krakëllimat
Lehin edhe meteorët
Leh edhe vetë nata
Pas zogjve të ikur të mendjes
Zbresin yjet e vetmuara

Prishtinë, 26 qershor 2013

NJË KORB I BARDHË

Në çastin e fundit
Kur era m'i mbyllë sytë
Arkivoli i kaltër te shelgjishtet
Përjetoi pikëllimin
E mallkimit të pasqyrës

Një hutin i zi nate
Ia filloi një kënge të vjetër
Këndoi edhe era
Ky kor delikat
Po i përngjan simfonisë së Bethovenit

Ne nuk pritëm ardhjen e shirave
Stina i kishte veshur
Pantallonat e zeza të një balade
Dhe defilonte trotuarit
Si kukullat prej leckave

Një erë bliri
Zbriste nga bjeshkët e mira
Gjethet në ekzaltim e sipër
Këndonin një serenatë

2.

Valsi i mbrëmjes kishte hipur
Flluskave të dallgëve
Dhe i kalëronte pa dizgjin
Kuajt e kuq të mjegullave

Një natë si kjo
Mbase më duket natë e huaj
Në prehrin e lisave fshihen
Daullet e një stuhie

Një korb i bardhë
Ndoshta nuk i përngjan
As korbit më
Fluturoi me një krah të thyer
Mbi çatinë pa ulluk
Te një arkivol i harruar
Dëgjohen ngashërimet e erës

PO AQ EDHE E ETUR

Nëse nuk i hapni sonte portat
Si mund të gjej vend ëndrra ime
Në gjumin e lumit
Moj syjeshile

Thonë se
Përrallat nuk janë për të rritur
Po kush të foli për rritjen time
Moj sybajame

Isha dikur
Një djalë më dëshira dhe ëndrra
Me qindra zogj shpresash
Fluturonin nga koka ime
Moj dëshirë e zjarrtë
Sa e uritur
Po aq edhe e etur

Prishtinë, 27 qershor 2013

KUJTESË PA DYER E DRITARE

Unë asnjëherë s'isha mbret
E as ti mbretëreshë
Në këtë përzierje paska zënë vend
Ky pelegrinazh prej vegimi

Ishte vetëm një arkitekturë e brishtë
Në ngrehinën e dunës
Askund asnjë palë shkallë
Kujtesë pa dyer e dritare

Ngrica si e tërbuar i kafshonte çatitë
Pamë edhe arkivole te varret
Në brendinë e një muzike mortore
Përherë qante mështekna kur binte shi

Përjetuam edhe fundosjen e një fillimi
Ose të një fundi tragjik
Që nuk dihej se kah erdhi
Dhe ku po shkon

Ishim të huaj në qeniet tona klandestine
Po ashtu edhe mbetëm deri në fund
Unë asnjëherë nuk loza rolin tim
As ti nuk ishe
Në përfundimin e aktit të fundit

AJO

Ajo kishte dal nga banesa
Dhe i kishte shpërfillur
Të gjitha ëndrrat

Ecte në drejtimin e kundërt të erës
Në disa raste i përngjante
Merimangës së zezë

Në çdo hap të saj
Ose lindte nga një trishtim
Ose varroseshin ëndrrat e pa lindura

Një galop i papërfillshëm i erës
Mizorisht shkelte
Mbi supet e lodhura të mbrëmjes

Ecte e shpërfillur deri në mos durim
Nën këmishën e erës
E cila lëngonte nga lia e ujit

Pranvera shikonte shamitë e përshëndetjeve
Një dimër i zi
Si ujku i uritur qëndronte në pritë

Kur u pamë me këmishën e saj të verdhë
Menduam se gjelbërimi i syve të barit
Kishte marrë një tjetër ngjyrë

Kur u thyen xhamat e kujtimeve
Një bretkosë këndoi deri në mbrëmje
Serenatën e trishtimit të pasqyrës

HARABELAT

Çdo njeri e ka historinë e vet
Një palë këpucë vrapojnë rrugëve
Vrapojnë
Derisa të shqyhen shollat
Si një hartë e grisur prej letre
Po duket atdheu im

Disa zogj nëpër telat elektrike
Një kohë të gjatë
Kënduan një këngë patetike
Dallëndyshet më nuk fluturojnë
Në drejtim të atdheut tim

Një lejlek i zi
Mbase e ka humbur orarin
E itinerareve
Ilegalisht ka zënë vend
Në oxhakun e vjetër të fanarit
Dhe pret kthimin e peshkatarëve

Disa lloje të shpendëve
Që asnjëherë nuk janë parë në tokën tonë
Fluturojnë prej një ane
Në anën tjetër të pasqyrës së mallkimit
Harabelat as që mendojnë
Për ndonjë fluturim në drejtim të Jugut

NGA MALLKIMI I SHUPLAKVE

Nëpër atelienë e mjegullave
Mbrëmë dëgjuam
Disa lloje këlthitjesh
Zërat dëgjoheshin nga një thellësi
E dendur e uturimës

Krakëllimat vinin si një jehonë e lashtë
Mbi qiellin sterrë
Serenatat e korbave të çmendur
Pritnin të hapen perdet
E aktit të parë
Në teatrin e imagjinatës
Vdesin aktorët

Meteorët endacak
I kishin humbur të gjitha rrugët
Dhe qanin mbi një dunë prej rëre
Dy zogj të vendlindjes së Mjedës
Bartin disa zarfe të kaltra

Qielli i mbuluar me pikëllim
Trishtohej e trishtohej
Si një mace e uritur
Në sofrën e dhembjes
Ishin ulur këmbëkryq
Milingonat dhe vajtonin në kor

Kjo dhembje prej mishi
Nuk paska të ndalur sonte
Akoma çafkat e dehura
Në lotin e golgotës
Pinë ujë
Nga mallkimi i shuplakave

Cikli i tretë
Një zog i trishtuar

NËSE NGJAN E KUNDËRTA

Sonte jam diçka më shumë se vetvetja
Dhe shumë më pak se ajo hije
Që po i përngjan
Vdekjes së gështenjave të pjekura

Një hënë e re
Mbi kokën time tullace
Me gishtat e saja të holla
Qëndis këmishën e një meteori

Sa herë që ju takoj te varret
Më duket se
Po i përngjani arkivoleve
Disa kryqe të ngulura në tokë
Po i përngjajnë kësaj here
Një tjetër kryqi te mjegullat

Një qen i moshuar
Mbrëmë mbase qante si kërthi
Ose bisedonte më një tjetër lehje
Nën gjethet e manit të egër
Krimbat e mëndafshit
Po ia thurin një këmishë prej letre natës

Sonte dua të jem me vetminë e yjeve
Nëse ngjan e kundërta
Ju mos u bezdisni
Për këtë zbrazëti të imagjinuar
Sepse nata nganjëherë zhduket
Në xhepat e shqyera të vetvetes

ULEMI TE PRAGU I DERËS

Kur më premton koha
Pikturoj pasqyrën e pikëlluar
Dhe në syprinën e liqenit
Peshkun e artë

Në qytetin tim
Pranvera vonohet më shumë se çdo stinë
Por kur kthehet vjeshta
Një qukapik troket nëpër dyert e lisave

Ne si çdoherë jemi njerëz anemik
I përcjellim fluturimet e zogjve
Prej një çatie të vjetër
Në tjetrën çati vetëm me shikime të mrrolura

Kur lodhemi nga këto imazhe të rrejshme
Ulemi të pragu i derës
Dhe i përcjellim rosat e egra
Deri te çerdhet e mjegullave

NGA LËVORJA E DRURIT

Sonte nuk më pret asnjë njeri
Në këtë boshllëk
S'paska kohë
As koha e kaluar

Vetëm disa yje vezulluese
Me xhelozi
I përcjellin deri te portat
Delet e egra të qiellit
Nëpër kullosat e yjeve
I lëmë peng zogjtë e fëmijërisë

Nuk di
Por disi po pikon sonte
Një lloj rrëshire
Prej trupit të molisur të hënës

Kjo nostalgji
Që s'ka të mbaruar
Po i thyen për kokën time
Të gjitha shtambat e poçarit

Kur një melodi e vjetër
Zgjohet nga harresa
Njerëzit
Fillojnë të mbinë nga përrallat

Dhe i imitojnë për bukuri
Kukullat prej leckave
Njerëzit lindin mbase për herë të parë
Nga lëvorja e drurit

Prishtinë, 28 qershor

NJË ZOG I TRISHTUAR

Sonte duart e mia të lëngëta
Po i përngjajnë
Një peme të harruar
Asnjë kokërr molle s'paska mbetur
Në kopshtin e trëndafilave

Kur s'pata rrugëdalje
Rashë në dy gjunjë
Dhe e putha kaktusin e egër
Një gjarpër me syze
Te kopshti i profecisë
Flinte nën hijen e mollës

Ne i harruam edhe kësaj here
Dizgjinët e mallkimeve
Pranë portave të Ferrit
Fillonte vazhdimësia
E një rruge pambarim
Symbyllas ecëm
Deri në pikëllimin e pasqyrës

Ne nuk patëm kohë
Ose s'deshëm
Të mendojmë për të nesërmen
Një zog i trishtuar nga fajet
Kërkonte bekimin prej gjetheve të një molle

JONI NOSTALGJIK

Sa herë që takoheshim me makthet
Sajonim perëndi edhe prej balte
Kukullat tona si lecka të harruara
Kishin mbetur pa pikë loti

Më kujtohet kur dënesnin mjegullat
Kalorësit e rrufeve
Si të çmendur
I kamxhikonin meteorët
Kurse te varet qanin fëmijët e braktisur

Pas shirave i mbulonim kokat tona tullace
Dhe duke u fshehur pas arkivoleve
Qeshnim si të babëzitur
Hëna e dhunuar
Fshihej diku pas mjegullave

I përjetuam disa lloje torturash
Nënat me shamia të zeza
I mbulonin sytë
Një njeri qante te dunat e trishtimit
Joni nostalgjik
Hingëllonte si kali i egër

NJË ZOT I HARRUAR

Nën këmishën e natës
I ndezëm zjarret
Qirinjtë e harruar të një përralle
I kyçën kandilat te arkivolet e thyera
Nga xhepat e meteorëve
Pikuan mirazhet e një trishtimi

Peshkatarët po kthehen duarthatë
Pa anije
Dhe me rrjeta të zbrazura
Një Zot i harruar
Qante te dallgët
Fatin e një peshkaqeni

Në mol dikush i kishte kyç
Të gjitha yjet e natës
Asnjë fanar deti nuk fjeti mbrëmë
Nën gjuhën e peshkut fluturues
Çuditërisht buronte
Një tjetër det prej lotëve

TI ISHE DIKU ASKUND

Kur filloi si brejtësi
Të më brente vetmia
Ti ishe diku askund

Pastaj si një pasion i panjohur
Erdhi nata tinëzare
Dhe hyri ngadalë
Si trishtimi në shpirtin tim

Më duket se qenia ime
I përngjante një zbrazëtie
Të pafund

I preka sytë e trishtuar të sterrës
Kur erdhi agullima
Më humbën gishtat e duarve
Ku ishe ti dje
Dhe ku jam unë sot

Kur filloi
Çdo gjë nga e para
Unë isha një iluzion
Kurse ti
Një pikë vese
Mbi një gjethe që ikte me stinët

NJË YLL I VETMUAR

Sonte nuk qeshin njerëzit
Askush nuk kalon përtej lumit
Ura e thyer
Me një fashë prej trishtimi
I lidh plagët e Gjergjit

Një kohë të gjatë
Hingëllimat nuk pushuan
Në zbrazëtirën e qiellit
Era i shaloi mjegullat
Dhe iku tejpërtejmes

Hëna te një çati e rrënuar
I përcjellë zogjtë në vendlindje
Në jelet e kuajve të paçjerrë
Një yll i vetmuar
Këndonte një serenatë
Dashnorëve të pafat

ECIM ME NJË PASION

Mbaje mend këtë lojë
Ne nuk dimë
Ku fillojnë dhe ku përfundojnë
Ëndrrat e një nate

Ecim me një pasion
Prej zjarri
Kjo udhë e gjatë posa ka filluar
Të tkurret si defi i ciganes

Ne të gjithë ecim
Ose ngarendim deri te një pafundësi
Pranë vetmisë kjo rrugë e gjatë
Edhe hijet si iluzion vijnë pas nesh

Poqë se ndalemi
Duhet të kemi kujdes si dhelpra
Nën këmbët tona të shtrembëta
Fle një befasi e pasionuar

MBI ÇATINË E KUJTESËS

Kjo copë e grisur prej mjegulle
Dëneste te xhepat e erës
Lotët i shkonin rrëke
Një sutë e plagosur
Prej fjalëve
S'mund t'i ndalte ngashërimet

Qante edhe bari i fishkur
Ky kor i rrallë
Në hapësirën e paanë
Mbase ishte fillimi
Ose përfundimi i një përralle

Dita ngjyer me dhembje
Dënes si kërthi
Lotët e trishtë të përmallimit
Mbyten nën dallgët e Lumëbardhit

Mbi çatinë e kujtesës
Një lejlek i larmë qëndronte pa fjalë
Vetëm shikimet e mjegullta të kukuvajkave
Dukeshin si mirazhe
Të një tjetër bote
Në lotin e erës
Dita përjetoi përmbytjen e varkave

SËRISH DY ZOGJ TË PARAJSËS

Mbi këtë pllakë mermeri
Njollat e dukshme
Dhe të padukshme të gjakut
Kristalet prej dëbore
Si flokët e mjegullave
Pareshtur bien
Mes dy hapësirave

Një hap përpara shkallëve
Hija e saj e jeshilët
Ajo nën hijen
E hijes së gështenjës
Këndon një serenatë drithëruese
Te një dritare posa e hapur
Puthen dy zogj të parajsës

Shiu dhe era lozin
Çmendurisht lozin valsin e vjeshtës
Dora ime një degë e një peme
Fryti i përditshmërisë bie në tokë
Dhe bëhet shi prej zjarri

Nga zëri i tokës
Zgjohet një melodi
Sërish dy zogj të parajsës
Puthen në degët e mjegullave

ZOGJTË E URITUR

Një mall
Si një pemë rritet në mua
Eci bulevardeve blu
Kudo dritare dhe dyer të mbyllura

Sërish eci
Deri në pafundësi të kujtesës
Asnjë pemë frytdhënëse
Në çel zogj që fluturojnë në vendlindje

Ky mall i cili
Si llava zbret në shpirtin tim
Me çka mund ta shuaj
Trishtimin e pikëllimit në pasqyre

Në këtë mëngjes të varfër
Zogjtë e uritur
Po i dorëzohen melankolisë
Së mjegullave të trishtuara

Sërish një ecje e pakontrolluar
Pareshtur galopon
Nëpër flokët e mia të thinjura
Nuk di malli ose zjarri i Ferrit
Po e djegin këtë pemë
Që ka filluar të lulëzojë në mua

KURDOHERË KY TREN I ÇMENDUR

Asnjë udhëtarë nuk mbeti
Në trenin e mëngjesit
Zbritën edhe valixhet e fundit
Një kolonë prej pemëve degëthyer
Ecën trotuareve blu

Ky qytet posa i mbylli dritaret
Asnjë çati s'tregon mikpritje
Vetëm një zog i vetmuar
Në një shtyllë telefoni
Përshëndet kolonën e heshtur prej njerëzve

Rrugët e gjëra
I kanë lëshuar në gjysmështiza
Shikimet e vrara
Një zonjë e moshuar me taka të larta
Te barnatorja blen tableta gjumi

Kurdoherë ky tren i çmendur
Sjellë njerëz me valixhe të drunjta
Nëpër rrugët e boshatisura
Dëgjohen kërcëllimat e dritareve

Një tjetër zonjë me këpucë të rrafshëta
Rrëfen për pafajësinë
E udhëtarëve t**ë** mëngjesit

NJË VARR I HAPUR

Zëri dhe pianoja
I konvertojnë në gjethe flokët e erës
Një fjalë zbret prej tejpërtejmes
Etja me madhështi
Fundoset në shpirtin e mollës

Nën sofrën e pritjes
Mjaullima macesh të egra
Ku ishin dasmorët
Kur ecëm deri te legjenda
Atë ditë filloi përmbytja e profecisë
Një varkë e vetmuar vajtoi te fanari

Erdhën mjegullat dhe i kyçën shirat
Ikja ishte e gjatë
Më e gjatë se nata e thikave
Një zog endacak
Reciton poemën e mjerimit

Unë nuk kisha kohë
Dhe akoma jam te një fillim
I imagjinuar
Në pasqyrën e fëmijërisë
Një grua e moshuar
Me qindra vjet i kreh flokët

2.

Këtu në këtë lëndinë kufomash
Lindin si përherë
Shpirtrat e degëve të mirazheve
Një hënë e vrarë
Vajton fatin e yjeve të kalbur

Ne askund nuk i gjetëm
këpucët e arkivoleve
Një varr i hapur si dritaret pa xhama
Në syrin e djathtë të një peme
Përjeton ringjalljen e njeriut

NGA SYTË E TUA

Kur këndoje ti
I përngjaje një perëndeshe ilire
Flokët e tua të argjendta
E kishin aromën e barit të njomë

Sa herë që qeshje
Në sytë e gështenjtë të barit
Derdheshin shikimet e tua
Disa pika uji buronin të shelgjishtet

Flokët e mëndafshta të erës
I përngjanin reve të pambukta
Ku flinin perënditë e Olimpit
O asnjë Zot
Nuk mund të të mos dashuronte

Ti isha fjala
Dhe kryefjala e të gjitha ngjarjeve
Nga sytë e tua
Në vend të lotëve pelin
Pikonte
Një lloj balsami shërues

GOLGOTA E NJË TREGIMI

Në horizont
Si njerëzit ecin mjegullat
Një hënë e dehur
I ndez qirinjtë
Në fund të një gote
Shirat bien pak më ndryshe kësaj radhe

Nga çatitë e harruara të qytetit
Pikojnë ullukët e ndryshkur
Një buf i sëmurë
Në dënesje e sipër
Te një degë qershie i lëshoi vezët

Golgota e një tregimi
Sot po i përngjan përrallave
Të 1001 netëve
Te fanari i vjetër një njeri
Sonte i kyçi llambat e vajgurit

FRYJ SA TË DUASH

Fryj
Fryj sa të duash
Moj stuhi e çmendur
Askurrë nuk mundesh me i shkulë
Rrënjët e mia

Sa e sa ushtri kaluan këndej pari
Gjeneral të hekurt me kuaj prej druri
Kaluan edhe zjarret
Dhe asnjëherë
Nuk ishin në gjendje t'i djegin gjethet

Fryj
Fryj sa të duash
Moj stuhi e çmendur
Kjo tokë e regjur nga luftërat
Askurrë
Dhe askujt nuk i dorëzohet

Fryj
fryj sa të duash
Moj stuhi e çmendur

KUR MË ZURI PLEQËRIA

Vrapova korridoreve të etjes
I takova imazhet e ndrydhura
Asnjë kolibër
Nuk erdhi mbrëmë me letrën tënde

Kur të thirra
Ti ishe diku në fund të rrugës
Ose fundi as që ekzistonte
Në gjeografin e atdheut

Më kujtohet kur na i lëruan sinorët
Im atë qante
Kurse mua më dukej sa tragjike
Po aq edhe i trishtë vaji i burrit

Mbase isha fëmijë
Shumë pak jetova me atdheun
Andaj
Më dukeshin qesharak
Lotët e burrave

Kur më zuri pleqëria
Mes kudhrës dhe çekanit
Vetëm atëherë
Fillova të dashuroj
Çmendurisht ta dua atdheun e kafshuar

NUK DI A ISHTE FEMËR

Ajo si mistika doli nga balada
Dhe hyri në mesin tonë
Nuk di a ishte femër
Ose i përngjante sirenave të Uliksit

Ishte koha
Kur ndërroheshin këpucët
Me një palë sandale prej letre
Hijet e zeza herë zhdukeshin
E herë notonin si tërbimi i dallgëve

Një këndes kreshtë kuq
Në trarët e një druri
Ekzaltohej me baladat e kënduara

Rapsodi i kishte gjetur në harresë
Fijet kohës
Dhe këndonte një këngë
Vetëm kur këndonin edhe qyqet

Përtej maleve të mira
Dëgjoheshin piskama grash
Dhe krismat e pushkëve
Nuk pushonin
Herë britma gëzimi e herë trishtimi
Lëshonin rrënjët e lisave të moshuar

2.

Ajo sërish sonte
Po i përngjan një mistike
Që çel për çdo stinë
Nga një trishtimi prej hijeve
Dhe lëshon
Një zë aq të fortë
Sa që i shkund
Të gjitha gjethet e papjekura
Në flokët e thinjura të rrapit

Prishtinë, 30 qershor 2013

SHËNIME BIOGRAFIKE PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në

librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në kuadrin e Klubit letrar "Fahri Fazliu", në Kastriot.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010

32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-
Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013

79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot
86**.”Asnjë fjalë nuk frymon”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013-
87**.”Daullet e një nate”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2013
88**.”Sytë e gurtë të erës”**, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
89**.”Kur dehen perënditë”** , **Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2013**
90. **“Fjetëm njëqind shekuj”**Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2013
91.**”Krakëllimat e natës”,**Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2013

PËRMBAJTJA

Cikli i parë - Ishte koha e një pashai 11
Ishte koha e një pashai 13
2. 14
3. 15
4. 16
5. 17
6. 18
7. 19
8. 20
9. 21
10. 22
11. 23
12. 24
13. 25
14. 27
15. 28
16. 29
17. 30
18. 31
19. 32
20. 33
21. 35
22. 36
23. 37
Cikli i dytë - Krakëllimat e natës 39
Një zog shtegtar 41
Krakëllimat e natës 43
Ky fis 45
Kurse gjatë tërë ditës 46

Ende nuk jam i sigurt 48
Por këtë që bëjmë ne 49
Si trenat e verdhë 50
Njerëzit më nuk dinë 52
Një mjaullimë e zezë 53
Mallkimi i pasqyrës 55
Diku nga malet 57
Një korb i bardhë 59
2. 60
Po aq edhe e etur 61
Kujtesë pa dyer e dritare 62
Ajo 63
Harabelat 65
Nga mallkimi shuplakave 66
Cikli i tretë - Një zog i trishtuar 69
Nëse ngjan e kundërta 71
Ulemi te pragu i derës 73
Nga lëvorja e drurit 74
Një zog i trishtuar 76
Joni nostalgjik 77
Një Zot i harruar 78
Ti ishe diku askund 79
Një yll i vetmuar 80
Ecim me një pasion 81
Mbi çatinë e kujtesës 82
Sërish dy zogj të Parajsës 83
Zogjtë e uritur 84
Kurdoherë ky tren i çmendur 85
Një var i hapur 86
2. 87
Nga sytë e tua 88
Golgota e një tregimi 89

Fryj sa të duash 90
Kur më zuri pleqëria 91
Nuk di a ishte femër 93
2. 94

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Krakëllimat e natës / Adem Zaplluzha.
- Kastriot : Shtëpia botuese " Fahri Fazliu", 2014. - 109 f. ; 21 cm.

Adem Zaplluzha : f. 99-104

ISBN 978-9951-664-06-6